



## Koncept Ideja

### Workshop teknik

## Barazia Gjinore për zhvillimin e qendrueshëm në sektorët e Nexus në Shqipëri

*Do të organizohet online më 29 Qershor, 2021*

Në kuadër të projektit

*“Promovimi i menaxhimit të qendrueshëm të burimeve natyrore në Evropën Juglindore  
përmes qasjes së Nexus-it”*

*Mbështetur financiarisht nga Agjencia Austriake e Zhvillimit (ADA)*

*Zbatuar nga Global Water Partnership-Mediterranean (GWP-Med)  
Në partneritet me United Nations Economic Commission for Europe (UNECE)*

*Gjuha e punës është shqip, por do të ofrohet përkthim simultan në gjuhën angleze*

## Koncept Ideja

### Barazia gjinore në Shqipëri

Shqipëria ka bërë përmirësime të dukshme në përparimin e kornizës normative për barazinë gjinore gjatë viteve të fundit. Megjithatë, pabarazitë ende ekzistojnë, dhe struktura institucionale për barazinë gjinore mbetet me burime të ulta (si përsa i përket financave ashtu edhe burimeve njerëzore) dhe kërkon më shumë mbështetje për rritjen e aftësive teknike. Sfidat në zbatimin efektiv të kornizës ligjore dhe të politikave për barazinë gjinore ndikojnë negativisht në barazinë midis grave dhe burrave, si dhe zhvillimin e vendit në përgjithësi.

Për shkak të ndërhyrjeve të ndryshme, Shqipëria ka përparuar në disa fusha specifike më shumë se në disa të tjera çfarë edhe ndikon në përparimin e saj të përgjithshëm. Por progresi duhet të jetë i barabartë dhe i ngjashëm në të gjitha fushat kryesore të zhvillimit. Për shembull, Shqipëria ka treguar përparim në Indeksin Global të Hendeut Gjinor që përgatitet nga Forumi Ekonomik Botëror që prej vitit 2006. Në Indeksin e vitit 2020, Shqipëria u rendit në vendin e 20-të midis 153 vendeve të cilat u përfshinë në këtë raport. Ndërsa ky është një përmirësim i dukshëm krahasuar me vitet e mëparshme, ka ndodhur kryesisht si rezultat i rritjes së përfaqësimit zyrtar të grave në vendimmarrjen politike. Por ky progres nuk është i ngjashëm me arritjet e barazisë gjinore në të gjitha nën-indeksat e tjera të Indeksit si Fuqizimi Ekonomik dhe Mundësitë, Arritjet Arsimore dhe Hendeqet e Shëndetit dhe Mbijetesës.

Për të njëjtën arsye, Shqipëria ka rezultat mjaft të lartë dhe në Indeksin e Barazisë Gjinore të Bashkimit Evropian të botuar në vitin 2020, ku ka grumbulluar 60.4 nga 100 pikë të mundshme dhe renditet vetëm shtatë pikë nën mesataren e BE-28. Por një vështrim më i kujdesshëm tregon se ka ndryshime të konsiderueshme brenda kategorive të Indeksit. Pra, gratë kanë përparuar mjaftueshëm kur bëhet fjalë për t'u përfaqësuar në politikë dhe për të ndjekur arsimin e lartë. Por këto shifra janë në kontrast të jashtëzakonshëm me mungesën që gratë ndeshin në aksesin e burimeve thelbësore prodhuese, siç dëshmohet nga pikët e grumbulluara në sektorin e parave, përfitimin e përkujdesjes, përdorimin e kohës dhe fuqinë sociale.

Në Raportin e Zhvillimit Njerëzor të UNDP-së 2019, Shqipëria zë vendin e 69-të midis 189 vendeve, duke reflektuar një tendencë të përgjithshme dhe graduale në rritje gjatë dekadës së fundit. Sidoqoftë, Shqipëria shënon në nivelin më të ulët të zhvillimit në kategoritë "Fuqizimi i Grave" dhe "Hendeku Gjinor në kursin e jetës" specifikisht në fushat e mëposhtme: punësimi i grave në nivelin e menaxhimit të lartë dhe të mesëm; numri i vajzave në shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë (STEM); raporti gjinor në lindje; përqindja e punësimit të femrave jashtë sektorit të bujqësisë; dhe në punët e shtëpisë dhe punën përkujdesëse.

### Barazia Gjinore dhe Zhvillimi i Qendrueshëm

Thelbi i zhvillimit të qëndrueshëm synon të na inkurajojë se si të mendojmë për të përmirësuar ekonominë dhe shoqërinë pa çënuar mjedisin natyror ose mirëqenien e brezave të ardhshëm. Por që çdo përpjekje zhvillimore të jetë e qëndrueshme dhe efektive, duhet të marrë në konsideratë nevojat e të gjithë njerëzve, përfshirë edhe ata që tipikisht nuk kanë zë në

vendimmarrje. Kjo është arsyeja pse barazia gjinore është një përbërës kritik për arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm.

Barazia gjinore dhe zhvillimi i qëndrueshëm janë të pandashme. Barazia gjinore mund të mundësojë dhe madje të përshpejtojë arritjen e të gjitha Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG). Ndërsa barazia gjinore qëndron si një qëllim më vete (SDG 5), përfitimet e saj shumëfishohen kur gjinia integrohet në të gjitha SDG-të, dhe çështjet gjinore përfshihen në të gjithë punën mbi zhvillimin e qëndrueshëm.

Adresimi i pabarazive gjinore – përfshirë edhe aksesin dhe kontrollin mbi burimet natyrore - përshpejton ndikimin e politikave të zhvillimit të qëndrueshëm lidhur me Axhendën 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm. Shumë nga pengesat për politika efektive të qëndrueshmërisë gjenden në normat e vjetra diskriminuese shoqërore dhe në sistemet ligjore. Investimi tek vajzat dhe gratë nuk kërkon shpikje rrënjësore të reja, por mund të thyejë pengesat sistemike të pushtetit dhe privilegjit që vazhdojnë të lënë miliona njerëz pas.

### **Qasja Nexus dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm**

Zhvillimi i qëndrueshëm socio-ekonomik kërkon, ndër të tjera, nivele në rritje të shërbimeve ushqimore - energji dhe ujë. Siguria e përgjithshme e burimeve mund të përmirësohet duke bashkë-optimizuar objektivat e sektorëve të ndryshëm përmes një qasjeje të integruar Uji-Energjia-Ushqimi-Ekosistemet "Nexus" që synon pajtimin e interesave të sektorëve të ndryshëm, duke respektuar nevojat mjedisore dhe të drejtat e njeriut. Kjo arrihet duke adoptuar një qasje të integruar dhe të koordinuar ndërmjet sektorëve ndërsa vetë sektorët konkurrojnë për të njëjtat burime të pakta. E gjitha kjo ndodh duke marrë në konsideratë mundësitë ekzistuese dhe duke eksploruar mundësitë e reja në zhvillim. Nën një qasje të tillë, vlerësohen ndërlidhjet, sinergjitë dhe shkëmbimet ndërmjet sektorëve përkatës, me qëllim për të identifikuar zgjidhje që nxisin sigurinë dhe efikasitetin e energjisë-ujit dhe ushqimit dhe zvogëlojnë ndikimet dhe rreziqet në ekosistemet që varen nga uji.

Projekti "Promovimi i Menaxhimit të Qëndrueshëm të Burimeve Natyrore në Evropën Juglindore (EJL), përmes qasjes së Nexus-it" mbështetet nga Agjencia Austriake e Zhvillimit (ADA), dhe zbatohet nga Global Water Partnership - Mesdhe në partneritet me Komisionin Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropën (UNECE). Qëllimi kryesor i këtij projekti është të prezantojë qasjen Nexus dhe të katalizojë veprimin për miratimin dhe zbatimin e tij në EJL në nivelet e baseneve kombëtare dhe ndërkufitare. Për këtë qëllim, po zbatohen Proceset e Dialogut Nexus në basenet ndërkufitare të lumenjve Drin dhe Drina dhe në Shqipëri, duke përfshirë dhe Vlerësimet Teknike Analitike të Nexus.

### **Barazia Gjinore në Vlerësimin e Nexus në Shqipëri**

Nga një analizë fillestare gjinore, mund të vërehet se përkushtimi ndaj politikave dhe strategjive gjinore ndërkombëtare, kombëtare është i pranishëm në nivelin kombëtar, por politikat dhe strategjitë e sektorëve nexus, në përgjithësi, nuk kanë referenca të përshtatshme për gjininë,

përfshirë edhe sektorët e ujit-energjisë-mjedisit-ushqimit dhe ndryshimit të klimës, ndikimet e të cilave janë shumë të konsiderueshme sidomos tek gratë dhe zonat e varfra rurale.

Dimensionet gjinore dhe veçanërisht nevojat dhe sfidat e grave paraqiten më qartë sidomos në planet dhe strategjitë e zhvillimit rural dhe pjesërisht në menaxhimin e katastrofave si pasojë e ndodhive ekstreme klimaterike, të tilla si përmytjet. Për shkak të lidhjes së tyre të ngushtë me sektorët nexus siç janë bujqësia, shërbimet dhe menaxhimi i ujit, menaxhimi i mjedisit, ndërhyrjet në zhvillimin rural dhe përshtatja me përpjekjet ndaj ndryshimeve klimaterike mund të kontribuojnë në vënien në dukje të rëndësisë së integritit të çështjeve gjinore në Nexus. Sidoqoftë, fushat e tjera duhet të hulumtohen më tej.

Për të adresuar sa më sipër, nën Vlerësimin e Nexus për Shqipërinë, një kapitull i dedikuar për dimensionet gjinore do të përgatitet për të vlerësuar se si pasqyrohen dhe konsiderohen çështjet gjinore në sektorët e Nexus-it dhe cilat janë sfidat specifike për të realizuar një qasje më integruese të çështjeve gjinore në keta sektorë. Metodologjia për të përgatitur këtë kapitull do të jetë përmes rishikimit të dokumentacionit, zhvillimit të këtij seminari dhe një pyetësori për të identifikuar progresin, sfidat dhe fushat e mundshme të interesit për një qasje më të ndjeshme gjinore në secilin prej sektorëve të Nexus-it.

### **Fusha dhe qëllimet e workshop-it**

Në kuadrin të Vlerësimit të Barazisë Gjinore në sektorët e Nexus-it, ky takim teknik synon të nisë një diskutim të koordinuar midis aktorëve kryesorë dhe palëve të interesuara mbi rëndësinë e integritit të barazisë gjinore në sektorët Nexus për një zhvillim të qëndrueshëm. Ai gjithashtu synon të informojë dhe të diskutojë se si çështjet gjinore adresohen në strategjitë dhe politikat e sektorëve si dhe të sjellë disa praktika konkrete të mira se si çështjet gjinore mund të adresohen në programet e zhvillimit. Më konkretisht do të synojë të:

- Prezantohet dhe të përditësojë palët e interesuara të lidhura me Nexus me konceptet themelore mbi barazinë gjinore për zhvillimin e qëndrueshëm dhe sesi pabarazia gjinore ndikon në progresin drejt Agjendës 2030.
- Informojë mbi progresin e Shqipërisë në përmbushjen e detyrimeve të barazisë gjinore.
- Diskutojë rëndësinë e integritit gjinor në hartimin e politikave dhe si adresohet gjinia në strategjitë dhe politikat e lidhura me Nexus.
- Diskutojë mbi sfidat dhe mundësitë e lidhura me gjininë, të rëndësishme dhe përshtatshme për sektorët Ujë-Ushqim-Energji-Ekosisteme.
- Ndajw përvojat me politikat, praktikat më të mira dhe mësimet e nxjerra nga sektorët Nexus që kanë përparuar në adresimin e çështjeve gjinore në politikat dhe zbatimin e tyre.
- Sigurojë rekomandime për ndërhyrje për të ardhmen.
- Sigurojë rekomandime dhe kontribute mbi Vlerësimin e Barazisë Gjinore në sektorët Nexus.

## **Pjesëmarrësit**

Ky takim teknik synon të mbledhë së bashku përfaqësues nga sektorët Nexus veçanërisht specialistë gjinorë dhe pika fokale nga institucionet, agjencitë, specialistë dhe ekspertë të barazisë gjinore, institucionet ndërkombëtare dhe organizata të shoqërisë civile. Në këtë seminar, palët kryesore të interesit do të jenë të pranishme për të kontribuar në identifikimin e sfidave kryesore për të adresuar barazinë gjinore në të gjithë sektorët relevantë të Nexus.